

V E N D I M

I ASAMLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "ALBANERA" SH.P.K.
NR. 1 DATË 27.05.2006


Sot, date 27.05.2006, në selinë e shoqërisë "ALBANERA" sh.p.k. u mbledh Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve me rend dite:

- Pranimi në shoqëri i ortakut të ri, shoqërisë "ALBANERA" s.r.l.
- Shtimi i kuotave të kapitalit me 100.000 lekë si kontribut i ortakut të ri që pranohet në shoqëri.
- Krijimi i fondit të të veçantë të investimeve si mbivlerësim kotash të kapitalit themeltar të shoqërisë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) EURO, tërësisht i derdhur për llogari të shoqërisë nga ortaku "ALBANERA" s.r.l.
- Të tjera.

Mbledhja drejtohet nga administratori, zoti Krenar Fezga, i cili deklaroi se pas njoftimit të të gjithë ortakëve të shoqërisë sipas përcaktimeve të statutit, në mbledhje marrin pjesë 1. Krenar Fezga me 33% të kuotave, 2. Giuliani Silvano (përfaqësuar me prokurë nga zoti Krenar Fezga) me 27% të kuotave, 3. Zylkade Hoxhaj me 20% të kuotave (përfaqësuar me prokurë nr. 4519/200 datë 26.05.2006 Noter Boris M. Skendi nga zoti Avjeri Hoxhaj), që përfaqësojnë 80% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë. Në mbledhje mungon ortaku Margarita Fezga që përfaqëson 20% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, e njoftuar me letër rekomande Nr. 242455 datë 11.04.2006 pa paraqitur asnjë arsye. Në mbledhje merr pjesë edhe ortaku i ri që pranohet, "Albanera" s.r.l., përfaqësuar nga Krenar Fezga. Pas diskutimeve të gjera nga ortakët e pranishëm, Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve të shoqërisë, me votim unanim të të gjithë ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë 80% të kapitalit,

VENDOSI:

1. Pranimin në shoqëri të ortakut të ri, shoqërisë "Albanera" s.r.l. me seli në Verona, Itali.
2. Shtimi i kapitalit themeltar të shoqërisë me 100.000 lekë, si kontribut i ortakut të ri që pranohet në Shoqëri. Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 200.000 lekë.
3. Me nënshkrimin e kuotave të reja të kapitalit bëhet një shoqëri me 5 (pesë) ortakë. Kapitali i shoqërisë zotërohet si vijon:


- 
- a. "ALBANERA" S.R.L. zotëron 50% të kuotave të kapitalit, baraz me 100.000 lekë.
 - b. KRENAR FEZGA zotëron 16,50% të të kuotave të kapitalit, baraz me 33.000 Lekë.
 - c. GIULIANI SILVANO zotëron 13,50% të të kuotave të kapitalit, baraz me 27.000 Lekë.
 - d. MARGARITA FEZGA zotëron 10% të të kuotave të kapitalit, baraz me 20.000 Lekë.
 - e. ZYLKADE HOXHAI zotëron 10% të të kuotave të kapitalit, baraz me 20.000 Lekë.

4. Krijimi i fondit të të veçantë të investimeve si mbivlerësim kotash të kapitalit themeltar të shoqërisë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) EURO, tërësisht i derdhur për llogari të shoqërisë nga ortaku "ALBANERA" s.r.l.
5. Administrator i shoqërisë mbetet përsëri zoti KRENAR FEZGA.

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të kërkojë prane Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, depozitim të vendimit të asamblese se jashtëzakonshme të ortakeve Nr. 1 datë 27.05.2006, prane Zyrës së Regjistrimit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit të sipërm në dokumentacionin e shoqërisë "ALBANERA" shpk.

ORTAKËT E SHOQËRISË "ALBANERA" SH.P.K.

KRENAR FEZGA
KRENAR FEZGA



GIULIANI SILVANO


(Përfaqësuar nga Krenar Fezga me delegim të datës 15 shkurt 2006)

KRENAR FEZGA



PËR ALBANERA S.R.L.

KRENAR FEZGA



ZYLKADE HOXHAI

